

## FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: : “**Adi Profesional**” sh.p.k me Nr.Nipti: **K22113002I** me adresë: Tiranë Kashar, Rruga Butrinti nr.9.

Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur”, prokurim me mjete elektronike – Mallra me numër **REF-05752-09-20-2021**.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “**Blerje Kasa Automatike për Pagesat në Sheshparkimet e Mbyllura**”

**Fondi limit 14,000,000** (katërbëdhjetë milion) **lekë pa TVSH.**

Burimi i Financimit: vënë në dispozicion nga Buxheti i Tirana Parking, miratuar me V.K.B. Nr.172 datë 21.12.2020 të Këshillit Bashkiak të Tiranës “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2021-2023 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2021”

**Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: 75 (shtatëdhjetë e pesë) ditë** duke nisur nga data e lidhjes së kontratës.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **15.10.2021, ora 11:00**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

**Njoftojmë se, ka qenë pjesëmarrës në këtë procedurë ky ofertues me vlerën përkatëse të ofruar:**

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

**1.Operatori ekonomik “Adi Professional” sh.p.k**

**K22113002I**

Çmimi total i ofertës është **13,722,000** (trembëdhjetë milion e shtatëqind e njëzet e dy mijë) **lekë pa TVSH.**

Është Shqyrtuar oferta e paraqitur nga ofertuesi “**Adi Professional**” sh.p.k

Çmimi total i ofertës është **13,722,000** (trembëdhjetë milion e shtatëqind e njëzet e dy mijë) **lekë pa TVSH.**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se:

- I plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim.

- I plotëson kriteret e vecanta të përcaktuara në DST. Është paraqitur grafiku i lëvrimin sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentat e tenderit.
- Përsa i përket llogaritjes së vlerës së ofertës nuk ka gabime aritmetike.

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” kreu X neni 82, pika 3, Komisioni konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 92, Kreu XI të Ligjit 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik” si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, u konstatua se oferta e operatorit ekonomik **“Adi Professional” sh.p.k është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e cilesuar si ofertë të vlefshme.**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 93, Kreu XI të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, VKM Nr.285 dt 19.05.2021 Kreu X, Neni 82, pika 4 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” vlerëson në bazë të formulës së parashikuar në dokumentat e tenderit nëse oferta është apo jo anomalisht e ulët.

Oferta do të cilësohet anomalisht e ulët sipas përcaktimit të bërë në VKM Nr.285 dt 19.05.2021 Kreu X, Neni 82, pika 4 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Nga shqyrtimi që ju është bërë dokumentacionit të operatoreve ekonomike të paraqitur rezultoi vetem 1 nje oferte e vlefshme dhe rrjedhimisht përdoret formula e mëposhtme:

*“Në rastin kur janë të vlefshme **dy ose më pak** oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përllogaritur.”*

Fondi limit është **14,000,000 (katërbëdhjetë milion) lekë pa TVSH.**

Oferta **“Adi Professional” sh.p.k = 13,722,000** (trembëdhjetë milion e shtatëqind e njëzet e dy mijë) **lekë pa TVSH.**

**75% i Fondit Limit = 75% x 14,000,000 = 10,500,000**(nëntëqind e gjashtë mijë ) **Lekë pa TVSH.**

**Nga krahasimi dhe formula e përdorur rezultoi se oferta e paraqitur e vlefshme nuk është anomalisht e ulët** në bazë të nenit 93, Kreu XI të Ligjit nr.162, datë 20.11.2020 “Për Prokurimin Publik”

Për sa më sipër, pas shqyrtimit të hollësishëm të veprimeve të kryera, gjatë procedurës së prokurimit, duke u ballafaquar me dokumentat e tenderit, si dhe detyrimet ligjore për prokurimet publike, është arritur në konkluzionin, se oferta e paraqitur dhe e dorëzuar nëpërmjet sistemit elektronik nga operatori ekonomik, është e pranueshme dhe e vlefshme të kualifikohet, mbasi është në përputhje me kërkesat e ligjit të prokurimeve, plotëson kërkesat administrativo-ligjore dhe specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit të Autoritetit tonë Kontraktor.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se oferta e Operatorit Ekonomik **“Adi Professional” sh.p.k.** me adresë Tiranë Kashar, Rruga Butrinti nr.9 me vlerë **13,722,000** (trembëdhjetë milion e shtatëqind e njëzet e dy mijë) **lekë pa TVSH** është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 21.10.2021.